PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ZERI i POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Viti i 43-të i botimit
Nr. 93 (11.463)

E enjte, 18 prill 1985

Çmimi 30 qindarka

EMRI I SHOKUT ENVER HOXHA ESHTE I LIDHUR NGUSHTE ME HAPJEN E RRUGEVE TE GJERA, NE TE CILAT KA ECUR FITIMTAR POPULLI YNE NE VITET E EPOKES SE PARTISE

NDERIM E RESPEKT I THELLE NE MBARE ATDHEUN PER BIRIN ME TE LAVDISHEM TE PARTISE E TE POPULLIT, KOMANDANTIN LEGJENDAR, SHOKUN ENVER HOXHA

TE FORTE E TE BASHKUAR RRETH PARTISE

Shqipëria që s'e uli flamurin kurrë, shqiptari që askush s'e pa të ulë kryet, u përkulën me nderim të thellë përpara Heroit, Udhëheqësit e Mësuesit, përpara emrit dhe veprës së tij, që s'vdes kurrë, me zi në zemër, me lot në sy.

U bënë tetë ditë që udhëheqësin e Partisë e të popullit, shokun Enver Hoxha nuk e kemi midis nesh. Kjo dhimbje e jashtëzakonshme e pikëllimi i madh preku thellë zemrat e komunistëve, të fëmijëve e pleqve, të të gjithë popullit tonë. Eshtë kjo shprehje e ndjenjave të larta, të dashurisë së pakufishme, e besnikërisë së patundur dhe e premtimit solemn të një populli të tërë se s'ka forcë që të na ndajë nga Partia, nga rruga që ka caktuar shoku Enver. Parti e popull një e të pandarë, në halle e gëzime. Kështu do të ndodh edhe në të ardhmen.

Në çaste të rënda të historisë shqiptari e ka zakon të mos e humbasë kurrë toruan e besimin, të mos ligshtohet. Humbja është e madhe, më e madhja që kemi ndjerë, por shoku Enver, udhëheqësi i Partisë e i popullit na ka mësuar që hidhërimin ta kthejmë në forcë. Eshtë meritë e shokut Enver, është edukatë e Partisë, janë traditat tona të shkëlqyeshme, guximi e trimëria, që e kanë bërë popullin të qëndrojë i pamposhtur në çdo situatë të rëndë e përballë çdo vështirësie. Zemrat gjithnjë lart, besimin dhe forcën të patundur. E fuqishme kjo ndjenjë është shprehur edhe gjatë gjithë këtyre ditëve. Në homazhet për të nderuar figurën e ndritur të Udhëheqësit të madh, në mijëra e mijëra letra e telegrame dërguar Komitetit Qendror të Partisë, në mitingje e mbledhje në të gjithë Shqipërinë, në poezitë dhe këngët, në vargjet e fjalët e zemrës, komunistët, i gjithë populli ynë betohet: «Do ecim në rrugën e Enverit e të Partisë. Dhimbjen do ta kthejmë në forcë». Këtë betim të zjarrtë e bëri edhe Komiteti Qendror i Partisë, gjithë Partia e populli për ta çuar përpara veprën e madhe që ka krijuar Enver Hoxha.

Shoku Enver na la një Parti të fortë, monolite e të pastër si drita, dhe një Shqipëri të lulëzuar, së cilës i kushtoi jetën e veprën e tij të paharruar. Përparimet tona nën udhëheqjen e Partisë me në krye shokun Enver në të gjitha fushat e jetës, në industri e bujqësi, në arsim e kulturë, në mbrojtjen e vendit, në shkencë etj. janë madhështore. Në themel të tyre ka qëndruar e qëndron uniteti Parti-Popull, «kyçi i artë» i fitoreve tona, siç e ka quajtur shoku Enver. Prandaj tingëllon e do të tingëllojë përherë aktuale Thirrja e tij drejtuar popullit shqiptar me rastin e 40-vjetorit të çlirimit. «Ta ruajmë si sytë e ballit gjithçka që kemi arritur, ta zhvillojmë me konsekuencë më tej, t'u lemë brezave të ardhshëm një Shqipëri kurdoherë e më të fortë, kurdoherë të kuqe, si flakë e pashuar e zemrave dhe e idealeve komuniste e partizane, një Shqipëri që të rrojë e të përparojë në shekuj».

Porositë e mësimet e shokut Enver, vepra e shembulli i tij i ndritur do të frymëzojnë e do të ngrejnë në këmbë njerëzit tanë për të qenë përherë në punë e në sulm. Që drita e hidrocentraleve të mos shterojë, që gjelbërimi i bimëve të ngjitet më tej në majë male, që shkollat të gumëzhijnë gjithnjë nga zëri i fëmijëve, që njeriu ynë, vepra më e madhe e Partisë dhe e shokut Enver, zot i fateve të veta, të jetë gjithmonë i lumtur e i gëzuar, Parti e popull qëndrojnë në këmbë, syzgjuar.

Në luftën për çlirimin e Atdheut e ndërtimin e socializmit, ne kemi arritur fitore të mëdha historike. Kjo ndodhi sepse populli ynë ia besoi Partisë fatin e vet, se u lidh për jetë me të e ndoqi hap pas hapi rrugën e saj. Bashkimi bën fuqinë, thotë populli. Uniteti i çeliktë i popullit me Partinë tek ne është një realitet i mrekullueshëm. Në themel të tij është bindja e masave për drejtësinë e vijës marksiste - leniniste të Partisë, për besnikërinë e guximin e saj në mbrojtje të interesave të popullit, të lirisë e pavarësisë së tij. Prandaj atë që ka thënë Partia e ka bërë populli dhe atë që ka kërkuar populli e ka bërë Partia. Kjo e vërtetë gjen mishërimin e vet edhe në moton luftarake të popullit që e kemi ndjerë fort në zemër, secili, si përherë: «Parti-Enver-jemi gati kurdoherë».

Kurrë ndonjëherë populli shqiptar nuk ka qenë kaq i bashkuar në interesa, në pikëpamjet politike e ideologjike, në normat morale e në sjelljet shoqërore siç është sot. «Një për të gjithë e të gjithë për një», si vëllezër të bashkuar të një familjeje të madhe, me shpirt revolucionar e patriotizëm të lartë në punë, në mbrojtjen e Atdheut e të fitoreve të tij, - kjo është karakteristika e njerëzve tanë në epokën e Partisë. Dëshmi e fuqishme e këtij uniteti Parti-popull është edhe mbështetja pa rezerva që masat punonjëse i kanë bërë e i bëjnë politikës së brendshme e të jashtme revolucionare të Partisë, që ka çuar përpara çështjen e madhe të ndërtimit të socializmit dhe e ka ngritur lart emrin e Partisë e nderin e Shqipërisë në botë.

Këtë unitet të farkëtuar nga Partia në betejat heroike të çlirimit e në transformimet e mëdha socialiste, komunistët dhe i gjithë populli ynë do ta kalitin e forcojnë më tej. Në të qëndrojnë themelet e pushtetit popullor, liria e pavarësia e atdheut, e sotmja dhe e ardhmja jonë e lumtur. Eshtë ky unitet, kjo forcë e madhe e mur graniti që u ka bërë ballë armiqve të egër të brendshëm e të jashtëm, imperialistëve amerikanë e socialimperialistëve sovjetikë, revizionistëve të të gjitha ngjyrave, jugosllavë, kinezë e reaksionit botëror, ka shpartalluar intrigat e komplotet e tyre. Kalitja e mëtejshme e unitetit të popullit rreth Partisë e Komitetit Qendror të saj është drita e syrit e jeta për çdo komunist, patriot e punonjës të vendit tonë.

«Shoku Enver i porosiste vazhdimisht komunistët, theksoi shoku Ramiz Alia në mitingun e madh të përmortshëm në kryeqytet, të luftonin pa u lodhur për forcimin e vazhdueshëm të lidhjeve të Partisë me masat dhe të unitetit të popullit. Në këto lidhje e në këtë unitet ai shikonte mburojën e fuqishme ndaj armiqve të brendshëm e të jashtëm, një forcë të madhe lëvizëse e mobilizuese për të çuar gjithnjë përpara shoqërinë tonë, një burim energjie të pashterur për të përballuar çdo situatë». Shprehje e këtij uniteti është edhe gjendja e brendshme e shëndoshë e vendit, ekonomia jonë që ec gjithnjë përpara me hapa të shpejta e të vendosura, siguria e plotë për fitore të reja në të ardhmen.

Përherë vigjilentë, përherë në punë e në sulm për të çuar më tej fitoret e arritura. Ky është betimi i Partisë e i popullit, për ta bërë Shqipërinë tonë ashtu siç e donte shoku Enver, të fuqishme, të begatë e të përparuar.

Në këtë rrugë s'ka forcë që të ndalë Partinë, popullin, Shqipërinë socialiste.

ENVER HOXHA RRON NE VEPREN E PARTISE, RRON NE ZEMREN E MADHE TE POPULLIT

— Nga letrat dhe telegramet dërguar Komitetit Qendror të Partisë —

Në Komitetin Qendror të Partisë kanë ardhur këto ditë letra dhe telegrame të shumta nga punëtorë dhe kooperativistë, gra e intelektualë, ushtarakë e pionierë, të rinj e të reja, veteranë e veprimtarë shoqërorë, punonjës të arsimit e të shkencës, nga kolektiva e individë të shumtë në të katër anët e atdheut. Ashtu siç është e madhe dhimbja, po aq i madh e i vendosur është edhe premtimi që i bëjnë të gjithë, i madh e i vogël, Partisë sonë se do të ecim me vendosmëri në rrugën e saj të lavdishme, në rrugën e veprës së pavdekshme të shokut Enver Hoxha.

Vepra e shokut Enver Hoxha, shkruajnë në letrën e tyre punonjësit e Akademisë së Shkencave, është e pavdekshme. Ajo shtrihet në të gjitha fushat e jetës e të ndërtimit tonë socialist. Shoku Enver Hoxha na ka dhuruar një varg veprash madhore që do të mbeten në histori si mishërim i mendimit të tij krijues, si pasurim i pashoq i shkencës dhe i kulturës shqiptare, i mendimit shkencor marksist-leninist në përgjithësi. Ai jo vetëm u kujdes drejtpërsëdrejti për përparimin e të gjitha shkencave duke u hapur atyre perspektiva të reja me shikim të largët, por edhe zbërtheu konkretisht me mjetet e analizës shkencore, thesaret dhe aftësitë krijuese të këtij populli, të shprehura në historinë, kulturën, gjuhën dhe artin kombëtar. Kurrkush nuk e mishëroi më mirë se ai fisnikërinë shpirtërore të popullit shqiptar, zemrën e tij të madhe, shpirtin e tij të bukur. Të gjithë ne, punonjësit e Akademisë së Shkencave do të luftojmë për ta ngritur përherë e më lart cilësinë e veprave tona, të shkencës sonë socialiste, me atë guxim, me atë shembull të madh e ndjenjë të lartë përgjegjësie që na ka rrënjosur në mendje e në zemër i pavdekshmi Enver Hoxha.

Shoku Enver ka bërë shumë për lumturinë e popullit tonë, shkruajnë në letrën e tyre të rinjtë dhe të rejat e shkollës së mesme bujqësore të Dervicianit në rrethin e Gjirokastrës. Ne kemi fatin e madh që u lindëm e u rritëm në këto ditë të bukura të pranverës socialiste, në këtë Shqipëri të lumtur e të pavarur, në këtë Shqipëri të fortë e të begatë. Prandaj nga thellësia e zemrave tona i shprehim Partisë dhe Komitetit të saj Qendror betimin tonë solemn, se do ta mbajmë gjithmonë lart flamurin e Partisë, veprën e pavdekshme të shokut Enver Hoxha.

Ne, shkruajnë pionierët e Shmilit, i japim Partisë fjalën e nderit të «Pionierëve të Enverit», se do të ecim kurdoherë në rrugën e lavdishme të saj, në rrugën e të shtrenjtit xhaxhit Enver. E kemi për nder e krenari, vazhdojnë ata, që jemi fëmijët dhe nipërit e mbesat e prindërve dhe partizanëve heroikë të Shmilit, që strehoi strategun e shquar të luftës heroike Nacionalçlirimtare dhe Komandantin legjendar, shokun Enver Hoxha.

Si në çdo pëllëmbë tokë të Shqipërisë, shkruajnë në telegramin e tyre veteranët dhe të rinjtë e qytetit të Tepelenës, edhe në malet e Labërisë, është dora, mendja, zemra dhe kujdesi i veçantë i Partisë dhe i shokut Enver. Ndaj vajtojnë nënat labe, ndaj rënkojnë thellë zemrat e minatorëve për këtë humbje të madhe. Të paharruara do të mbeten për ne, për gjithë popullin e Tepelenës takimet dhe vizitat e shokut Enver me minatorët e Memaliajt, me kooperativistët e Krahësit, me blegtorët e Dukajt, me shkollarët e Sinanajt, etj. Të paharruara do të mbeten edhe letërkëmbimet e shumta me nënat e dëshmorëve e heronjve të Kurveleshit e të Tepelenës, që shoku Enver i deshte si nënën e gjirit dhe ato e deshën si dritën e syrit.

VII e mban gjithë kombi mbarë

Rapsodi popullor Gjokë Beci nga Mirdita, e shpreh dhimbjen e thellë të popullit, por njëkohësisht edhe betimin e tij solemn për të ecur vendosmërisht në rrugën e

(Vijon në faqen 2)

Shoqja Nexhmije Hoxha dhe pjesëtarët e tjerë të familjes duke bërë homazhe pranë varrit të shokut Enver Hoxha. (Foto: ATSH)

Homazhe pranë varrit të Udhëheqësit të dashur e të lavdishëm shokut Enver Hoxha

Mijëra e mijëra njerëz, nga i gjithë vendi, veteranë të luftës e të punës, punëtorë e kooperativistë, ushtarakë, të rinj e të reja, anëtarë të organizatës «Pionierët e Enverit», këto ditë marrin rrugën dhe ngjiten në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Vijnë të nderojnë kujtimin e shokut Enver, Udhëheqësit, Mësuesit, Shokut, Vëllait, Mikut të njerëzve të thjeshtë. Vijnë me dhimbje të thellë, derdhin lotë, përulen me respekt të madh pranë varrit të prijsit legjendar të Luftës Nacionalçlirimtare dhe udhëheqësit heroik të ndërtimit të socializmit, shokut Enver Hoxha. Mblidhen rreth tij, grusht pranë njëri tjetrit, prekin me dorë të dridhur gërmat e arta përjetë të dashura të emrit të tij të gdhëndura mbi mermerin e kuq: «Enver Hoxha 1908-1985».

Vijnë dhe vendosin buqeta me lule mbi varrin e njeriut më të shtrenjtë të zemrave të tyre që për gjysëm shekulli mendoi e punoi për ta, i dëgjoi si bir i thjeshtë dhe e dëgjuan si prind të vërtetë. Mal me lule mbi varrin e udhëheqësit të lavdishëm. Eshtë një dashuri e pafund, që lindi dhe u rrit në ato ditë të vështira, kur maleve kërciste pushka partizane, në betejat heroike të ndërtimit socialist të vendit, në gëzimet dhe festat tona të mëdha... Eshtë dashuria e një populli të tërë, e çdo zemre dhe vatre shqiptare.

Vijnë njerëzit grupe grupe dhe nderojnë me respekt kujtimin e veprës së ndritur dhe të pavdekshme të shokut Enver Hoxha, që eshtë në të gjitha themelet e shëndosha mbi të cilat eshtë ngritur atdheu ynë i bukur dhe i fortë. Qëndrojnë në heshtje me lot në sy dhe pikëllim në zemër, me peshën e dhimbjes së rëndë për humbjen e Udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit shokut Enver Hoxha. Me dhimbjen e tyre të thellë shprehin mirënjohjen e pakufishme për Partinë. Me fjalën e mënçur e të urtë

(Vijon në faqen 2)

http://www.enverhoxha.ru

NDERIM E RESPEKT I THELLE NË MBARE ATDHEUN PËR BIRIN ME TË LAVDISHËM TË PARTISË E TË POPULLIT, KOMANDANTIN LEGJENDAR, SHOKUN ENVER HOXHA

(Foto: ATSH)

Homazhe pranë varrit të Udhëheqësit të dashur e të lavdishëm shokut Enver Hoxha

(Vijon nga faqja 1)

të Enverit ata kanë njohur vetëm fitore e gëzime, jetojnë ditët e lumtura *të epokës socialiste*.

Vijnë njerëzit varg, bëjnë homazhe pranë varrit të shokut Enver Hoxha dhe me grushtin lart betohen përpara veprës dhe jetës së Tij: «Të rrojë Partia! Ju betohemi, shoku Enver, se Shqipërinë e lirë dhe të pavarur, të nderuar e të respektuar në botë, që na latë ju, do ta kemi kurdoherë e më të fortë, kurdoherë të kuqe, si flakë e pashuar e zemrave dhe idealeve komuniste e partizane, një Shqipëri që të rrojë e të përparojë në shekuj, ashtu si e donit ju lart e më lart do ta mbajmë flamurin tonë fitimtar, lart e më lart do ta ngremë emrin dhe prestigjin e saj, më përpara do ta çojmë revolucionin dhe ndërtimin e socializmit! Derisa të na rrahë zemra do të jemi bij besnikë të devotshëm të Partisë dhe të popullit.

Dje paradite bënë gjithashtu homazhe pranë varrit të shokut Enver Hoxha, shoqja Nexhmije Hoxha, bashkëshortja dhe bashkëpunëtorja e tij, dhe pjestarët e tjerë të familjes.

(ATSH)

ENVER HOXHA RRON NË VEPREN E PARTISË, RRON NË ZEMREN E MADHE TË POPULLIT

(Vijon nga faqja 1)

Partisë e të shokut Enver Hoxha, në vargje:

Në zemër të popullit e të Partisë
Ngulet dhimbja e gjithë Shqipërisë
Por të gjithë lidhur prej një bese
I kthejnë zemrat në gurë fortese.

Ndarja nga ne e birit më të shtrenjtë të Shqipërisë është shumë e dhimbshme, shkruan në telegramin e saj Lirije Spirollari, mbesa e Maro Mokrës. Por bashkë me lotët ne betohemi se do të qëndrojmë grusht çeliku rreth Partisë për ta bërë akoma më të lulëzuar e më të fortë Shqipërinë tonë socialiste.

Në këto momente hidhërimi, shkruajnë fatosat, pionierët, të rinjtë dhe mësuesit e shkollës të Shtiqnit në rrethin e Kukësit, mendja na shkon tek porositë shumë të çmuara të shokut Enver, tek librat me shumë vlerë të tij «Për ju pionierë», «Vitet e vegjëlisë», «Mbi themelimin e Rinisë Shqiptare», «Për arsimin dhe edukatën» etj. Në jetë të jetëve do të qëndrojmë bij besnikë të mësimeve të shokut Enver Hoxha, ushtarë të vendosur të Partisë sonë të lavdishme të Punës.

(Sipas ATSH-së)

U KA HIJE LOTI DHE QENDRESA

– Nga takimet dhe bisedat për Komandantin me disa ushtarakë –

U bë më shumë se një javë që Komandanti s'është më midis nesh. Mësoi për këtë dhimbje të madhe detari dhe për një çast u duk sikur u nguros mbi kuvertë, e dëgjoi tankisti dhe heshtja u nder nga makina e tij gjëmimtare. I erdhi ky lajm ushtarit të thjeshtë dhe mpaku frymëmarrjen tek zinte pozicionin në llogore, e dëgjoi aviatori dhe s'u besoi veshëve, mos kishte defekt në shlemafonin e tij?! E kush donte të besonte këtë gjëmë të madhe për humbjen e Komandantit. Ai na ishte bërë simbol i përjetësisë dhe kështu do të mbetet.

Më datën 10 prill ushtari Ndre Matia nga Lezha ndodhej në shtëpi me leje, nga që i kish vdekur e ëma. Por ç'ndodhi me të? Të nesërmen, ai u kthye me një frymë në repart. Kur e pyetën shokët, ai tha vetëm kaq: «Dhimbjen që më shkaktoi vdekja e nënës e përballova me njerëzit e mi të familjes, dhimbjen që më shkaktoi vdekja e Komandantit s'isha në gjendje ta përballoja atje, ndaj u ktheva te ju, shokë, në familjen tonë të madhe...». Sytë e të gjithëve janë të përlotur e një ngërç i çpon si thikë në shpirt. U ka hije loti dhe qëndresa, fjala dhe besimi, heshtja dhe uniteti. Kushdo që do të përpiqej ta cënonte atë, do të dukej i vetëm, i mjerë, i pafuqishëm.

- Ne shqiptarët e kemi pasur për traditë - thotë ushtaraku Sali Dibra që dhimbjet kurdoherë na kanë mbledhur, na kanë bërë t'i gjendemi më pranë njëri-tjetrit. Me një piskamë, pa fjalë e urdhra jemi marrë vesh nga shpati në shpat e jo më sot...

Në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve që mban emrin e Komandantit, u takuam dhe biseduam me shokun Rustem Peçi. Nga gjoksi i tij befas, del një frymëmarrje e zgjatur. Natyra ka ligjet e veta, - na thotë I ka të forta. Por dhe ne, kështu do të qëndrojmë. Të fortë, ballëlart. Kështu qëndronte Komandanti gjithmonë, kështu na mësonte të qëndrojmë.

- Në këtë shesh e te kjo shkollë, shoku Enver ka ardhur shpesh. Na ka takuar, na ka përgëzuar e porositur. Dhe ne e kemi dëgjuar duke e vështruar në dritën e syrit Komandantin.

Në sheshin e shkollës bëheshin përgatitje që askush s'donte t'i afronte në mendje: Skorta e nderit, kortezhi i përmortshëm, reparti i shoqërimit!... Për kë vallë? Për përcjelljen e fundit të Komandantit. Ndaj i është zënë goja oficerit Patriot Aliaj e shokëve të tij që do të ngrinin mbi supe arkivolin me Komandantin. Ndaj u është përtharë buza, ashtu siç nuk u është tharë ndonjëherë fushimeve dimërore me erë e suferinë... Çfarë të na thonë për bashkëkohësit e brezat që do të vijnë: E madhe është dhimbja jonë, si qëndresa dhe forca jonë!

Ja dhe dy ushtarakët flamurtarë: studentët Ibrahim Bejo dhe Ilir Zaimi: Kur u afrua Komandanti pranë nesh në rreshtimin me rastin e 40-vjetorit të Ushtrisë Popullore, ai u përkul dhe puthi Flamurin e Flotës Luftarake Detare që e mbanin detarët e shkollës «Hysni Kapo», pastaj u drejtua përpara nesh. Puthi flamurin e shkollës sonë. Ne u bëmë me krahë. Komandanti na përgëzoi me dorë, me sy, buzëqeshje... Pastaj kaloi në revistë ushtarakisht, ashtu shtatlartë e madhështor. Kush nuk do ta pranonte një fat të tillë, të gjëndej pranë tij. Këtë «privilegj» ne, që kur ishim skënderbegas e patëm 10 herë, në parada të ndryshme, manifestime, përvjetore, në Varrezat e Dëshmorëve...

- Përgatitjet që po bëjmë këtë herë janë ndryshe. Shtiza e flamurit na vjen mal e rëndë - na tha Ibrahimi. Por zemrën e kemi prush e të fortë. Pas dy muajsh ne do të dalim oficerë. Kudo që të emërohemi do të qëndrojmë ushtarë besnikë të Partisë, popullit, siç na porosiste vetë Komandanti.

- Sapo u kthyem nga një shërbim kur ndiqnim zbatimin e një detyre që na kish vënë Komandanti, - na tha zëvendësministri i Mbrojtjes Popullore Jaçe Lula. - Nuk më hiqet nga mendja takimi i parë me shokun Enver. Kam qenë skënderbegas atëhere. Ishte mbrëmja e Vitit të Ri 1952. Komandanti u gëzua shumë kur mësoi për rezultatet tona në mësime dhe na afroi që të bënim një foto si kujtim. Dashurinë dhe kujdesin që tregonte për ne kur qemë skënderbegas, e ruajti gjithë jetën, edhe kur u burrëruam e Partia na bëri kuadro në njësitë dhe repartet e ushtrisë. Gjithnjë na përqafonte, por edhe na qortonte kur punët nuk na ecnin si duhej, ama, kurdoherë na frymëzonte me fjalën e tij. Ndaj s'do të ketë kurrë gjunjëzim për ne. Armët, të pathyera do t'i kemi përballë çdo armiku». Ndërsa Bardhyl Taçi, na tregon se në një takim në tetor të 1979-ës shoku Enver u kënaq shumë me pilotët. «Partia ka përgatitur pilotë të zot, tha, që do t'i kishte zili, çdo vend». Dhe pilotët, si mbarë populli e ushtria, e deshën me kokë Partinë dhe Komandantin...

Takojmë dy shoqe ushtarake: Arta Dama dhe Zana Treni. Ja ç'na thonë ato: Shkoi këtu qëparë një grua e moshuar.

- Bija, ku e ka shtëpinë shoku Enver, se s'para shoh mirë nga sytë na tha.

- Nëno, kalo këndej me kolonën, se del në selinë e Presidiumit të Kuvendit Popullor...

- Jo, bija, jo nëna ka ardhur nga Shkodra të shkojë në shtëpinë e birit. Ai nuk vdes, - tha, dhe bëri tutje andej nga i treguam ne.

ROLAND MUSTA

Frymëzuesi i planeve tona 5-vjeçare

Shoku Enver Hoxha është hartuesi dhe projektuesi i vijës ekonomike të Partisë, arkitekti i strukturës komplekse, shumëdegëshe të ekonomisë sonë, që duke u mbështetur plotësisht në forcat e veta, zhvillohet me ritme relativisht të larta e të qëndrueshme dhe që nuk njeh kriza, stanjacion, papunësi, inflacion, ngritje çmimesh dhe shtrenjtësim të kostos së jetesës së masave punonjëse. Për të arritur deri këtu, shoku Enver u bë frymëzuesi i planeve tona pesëvjeçare të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës sonë socialiste. Ai i shihte planet si sintezë të zhvillimit e të përparimit të vendit, si mjet për konkretizimin dhe zbatimin e politikës së Partisë për zhvillimin e forcave prodhuese dhe përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim, për vënien në jetë të programit të saj për ndërtimin e socializmit.

Vepra e shquar e shokut Enver e përfaqësuar nga seria e veprave, raportet dhe fjalimet në Kongreset dhe Plenumet e Komitetit Qendror të Partisë, sidomos vepra madhore «Për planin e shtatë pesëvjeçar» janë një model i përkryer i shtjellimit, analizës, përgjithësimit dhe argumentimit të teorisë e të praktikës sonë në fushën e planifikimit. Ato janë një manifest programatik, ku masat tona punonjëse, të cilat përbëjnë mendjen dhe duart e zhvillimit e të përparimit të vendit, - siç shprehej shoku Enver Hoxha, - ekonomistët dhe financierët tanë, drejtuesit e prodhimit dhe të ekonomisë gjejnë orientime, mësime dhe rrugëzgjidhje sa të thella aq edhe të larmishme se si duhet hartuar një plan pesëvjeçar dhe se si duhet luftuar për realizimin e tij.

Veçanërisht, tani që është duke u hartuar projektplani i 8-të pesëvjeçar, rëndësi ka zbatimi i porosive të shokut Enver Hoxha që: çdo detyrë dhe problem i planit të shtjellohet dhe të diskutohet nga këndi i interesave të përgjithshme, duke iu shmangur tërheqjes pas interesave të ngushta, lokale e dikasteriale; që çdo detyrë e planit të jetë sa më reale, as e vogël dhe e lehtë për t'u realizuar, por as edhe «ambicioze» dhe e paarritshme, që çdo gjë duhet planifikuar shtrënguar, duke vënë në rendin e ditës kursimin, kudo, në çdo formë e në çdo lloj; që çdo detyrë të mbyllë shtigjet për lindjen e shpërpjesëtimeve e të shfaqjeve që nuk janë në natyrën e rendit tonë socialist, siç janë: inflacioni, papunësia, ngritja e çmimeve etj.

PRIAMO BOLLANO
doktor i shkencave ekonomike

Udhërrëfyesi i pagabuar

– Kujtime nga ish-drejtori i Drejtorisë së Reformës Agrare –

Drejtoria e Reformës Agrare u krijua sapo shoku Enver Hoxha deklaroi: «Qeveria po punon për hartimin e ligjit të Reformës Agrare», në shkurt të 45-ës, në Kongresin e 2-të të Rinisë. Më caktuan drejtor të asaj drejtorie. S'do të flas për punën që u bë për hartimin e ligjit e për zbatimin e tij. Një ditë ra zilja e telefonit. E ngrita receptorin.

- E mo Stavri, u ktheve nga shërbimi? Më kanë thënë që e ke marrë me shumë qejf këtë punë. Mirë bën. Reforma Agrare është në interes të popullit, të Partisë.

Të nesërmen, u takova në zyrë me shokun Enver. Pasi e informova për punën që po bëhej, ai më pyeti:

- Tapitë i përgatitët? I keni bërë të bukura?

-...! Po, unë mendova se s'do japim tapi. Ne do bëjmë kolektivizimin....

- Jo, Stavri, janë gabime këto. Kolektivizimi do bëhet kur t'i vijë koha. Tapitë do të jepen. Jo vetëm mos i nënvlerësoni tapitë, po, siç thashë, t'i bëni të bukura.

Kush më tepër se ai njihte psikologjinë e fshatarëve?!

Kishim menduar që dy-tre veta të shkonim në Gorre e të shpërndanim tapitë e para. «Jo, jo - tha shoku Enver. - Atje duhet të organizohet një miting popullor. Ta marrë vesh myzeqari, ta marrë vesh e gjithë Shqipëria, ta marrë vesh bota se fshatari shqiptar u bë zot i tokës.

Ishte mendja e ndritur e shokut Enver, ishte dora e kujdesshme e tij, që Reforma Agrare përfundoi me sukses të plotë e brenda një kohe rekord. Dhe në një çast vendimtar, kur bëhej revolucioni i parë në marrëdhëniet shoqërore-ekonomike të fshatit, ai drejtonte këtë revolucion. Ishte ideja e tij krijimi i Komiteteve të fshatarëve të varfër në çdo fshat e në çdo rreth, që do të ndihmonin Partinë, siç e ndihmuan, për zbatimin e Reformës Agrare, duke verifikuar punën që bëhej, duke denoncuar veprimtarinë armiqësore të klasave të përmbysura. Ishte konsekuenca e një revolucionari komunist, e një patrioti të flaktë, pse u mënjanuan shpejt edhe disa gabime që u bënë në ligjin e Reformës Agrare, nën presionin e titistëve dhe ndikimin e Sejfulla Malëshovës...

...E gjithë vepra madhështore e Partisë për transformimin socialist të fshatit, për zhvillimin e modernizimin e bujqësisë, ka në themel idetë drejtimin dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të shokut Enver, udhërrëfyesit të pagabuar.

STAVRI MARJANI

http://www.enverhoxha.ru

NDERIM E RESPEKT I THELLE NE MBARE ATDHEUN PER BIRIN ME TE LAVDISHEM TE PARTISE E TE POPULLIT, KOMANDANTIN LEGJENDAR, SHOKUN ENVER HOXHA

«SI U BE BUSTI PER ENVERIN»

Gjithë këto ditë dhëmbjeje kam sjellë ndërmend rastet e lumtura që kam pasur për t'u takuar me shokun Enver. Këto kujtime ma rëndojnë pikëllimin, por herë-herë më mbushnin mendjen se njoftimi i hidhur që u dha nuk mund të ishte i vërtetë.

E pashë për herë të parë në pranverën e vitit 1940, kur kisha shkuar në dyqanin «Flora». Nuk më tërhoqi vetëm me pamjen burrërore, me portretin aq shprehës, që për skulptorin është fat ta takojë. «Ejani sa herë të doni», - më tha buzagas, po unë nuk e dija që kur të kthehesha përsëri në këtë dyqan, tanimë historik, nuk do ta takoja më. Ai shpejt doli në ilegalitet. Nuk e dija gjithashtu që, kur ta takoja pas 5 vjetësh, në atë portret do të shihja të shkrirë një personalitet historik me rëndësi të jashtëzakonshme në gjithë jetën shekullore të vendit, të kombit. Jepej një pritje në Pallatin e Brigadave; në sallonin qendror të të cilit qe vendosur busti i Skënderbeut. Aty pranë midis një grumbulli njerëzish dalloja shokun Enver dhe nuk ia ndaja për asnjë çast sytë. Në një moment pashë që shoku Enver u kthye andej nga kisha zënë vend dhe unë dhe përshëndeti me dorë. «Kush mund të jetë ai që përshëndeti shoku Enver?» - mendova të them të drejtën, jo pa zili. Ktheva kokën nga të dyja anët të shihja atë njeri të lumtur dhe m'u duk se nuk mori përgjigje. Vështrova përsëri andej. Shoku Enver e përsëriti më energjikisht përshëndetjen. Për mua?! Dhe, sikur ta kishte kuptuar gjendjen time shpirtërore, dëgjova zërin e tij të thellë:

- Paskal!

Vrapova si me komandë pranë tij...

Që nga ky takim, deri në vitin 1965, kur fillova punën për bustin, pata edhe raste të tjera të isha pranë shokut Enver. Në çdo takim, në çdo bisedë, zbuloja detaje që do të më ndihmonin shumë në punën time të ardhshme.

Për një bust të shokut Enver Hoxha kisha menduar prej kohësh. Po megjithatë, siç i ndodh çdo artisti përpara asaj që është madhështore, më dukej se nuk kisha forca «të matesha» me të. Pikërisht kur mendoja këto, në vitin 1965, më erdhën në studio drejtori i uzinës «Enver», sekretari i komitetit të Partisë dhe kryeinxhinieri. Më thanë:

«Duam të na bësh një bust të shokut Enver, që ta vëmë në ballë të uzinës. E pret masa e punëtorëve, e pret gjithë populli». Edhe unë vetë u çudita si e mbarova bustin brenda 6 ditëve. Veç 16 punimeve të deriatëhershme për personalitetin e shokut Enver, veç kujtimeve dhe konceptit artistik që tanimë e kisha krijuar, duhej edhe kjo nxitje nga ana e klasës, që mua më dha guxim krijues. Busti u zgjodh për në Ekspozitën e Arteve Figurative që u çel me rastin e 25-vjetorit të Themelimit të Partisë, së bashku me një punim tjetër timin, monumentin «Partizani fitimtar». Këtë ekspozitë e vizitoi edhe shoku Enver. U afrua pranë bustit. E vërteta është se e doja një mendim të tij.

- ...

- Populli më duket e ka pëlqyer, shoku Enver, - i thashë.

- Kur e pëlqen populli, - më tha ai, i ka vënë vulën.

Populli më shumë nga të gjitha punimet e mia pëlqeu bustin e shokut Enver. Mua më vinte mirë kur merrja vesh që ky bust kërkohej me shumicë, u riprodhua në shumë kopje dhe u vendos në qindra e mijëra vende në të katër anët e Shqipërisë.

Duke punuar për këtë portret kam dashur të derdh në të jo vetëm figurën më të shquar të të gjithë historisë sonë, por dhe dashurinë më të madhe që ka pasur ky popull, dashurinë për shokun Enver. Më kujtohet që në pranverën e vitit 1965 shoku Enver na erdhi në studio së bashku me shokun Ramiz Alia, kur po punonim bashkë me dy kolegët shtatoren e Skënderbeut. Ne iu lutëm të na jepte përshtypjet.

- Këtë monument, - na tha ai duke treguar shtatoren, - do ta pëlqejë populli. Ky është Skënderbeu ynë. Në fytyrën e tij lexoj telashet e kohës...

Fjalët e fundit më mahnitën...

...Isha dhe unë këto ditë dhe bëra homazhe e roje nderi pranë arkivolit të shokut Enver. Kisha dëgjuar më parë shumë dashamirës të artit të më thoshin për bustin e tij: «E ke bërë të gjallë!». Po arti nuk mund të arrijë ta shprehë atë botë, atë personalitet, atë jetë aq të gjerë të tij. M'u kujtuan këto vlerësime edhe kur pasi bëra homazhe u takova këto ditë me shoqen Nexhmije, kur i shkova në shtëpi.

- Të foli? - më pyeti.

Sa herë është takuar me shkrimtarë e artistë, shoku Enver më thërriste pranë, më fliste për skulpturën, më këshillonte për veprat e ardhshme. Ishte hera e parë që ai nuk më fliste, duke qenë kaq pranë tij. Dhe atëherë pyeta veten: A flet busti që kam punuar unë? Kanë kaluar plot 20 vjet që kur ai u ekspozua për herë të parë. Janë 20 vjet të një pune titanike, të gjithanshme, punë Partie, shtetërore, krijuese e shkencore, që bustit tim i mungojnë. Ndjeva pengun më të madh të jetës sime, nuk arrita ta përfundoja një vepër të tillë, që ta shihte dhe ai. Por ndjeva dhe një detyrim e angazhim të madh moral t'i shtoj këtij busti këto njëzet vjet luftë të pandërprerë.

ODHISE PASKALI
Skulptor i Popullit

LOTET PO BEHEN VARGJE

E befasoi gurrën popullore lajmi i hidhur, i papritur.

Jo, mor jo, s'është e vërtetë...

Ç'qe kjo gjëmë e paparë,
Enver, na dogje xhanë...

Bjeshkët e nalta ulin kokën
Biejn n'gjunj e prekin tokën
Shqipja hesht, i rëndë flamuri...

Moj natyra kaq e mirë,
Që lind maj e që lind prillë,
Lule me erë e me shijë,
Pse shëmtove bukurinë
E bëre këtë mënxyrë...

Lotët po bëhen vargje.

Gurra popullore për gjysmë shekulli me radhë e kishte pasur pranë të gjallë Kryekreshnikun e saj legjendar, që e frymëzonte. Ajo pat qenë me fat që, në ditët e rënda të zgjedhës së huaj, iu gjind ai, që e ftoi popullin të ngrinte krye e të fillonte Epopenë më të lavdishme të historisë së tij kombëtare.

Rënkojnë malet rënkojnë
Enver Hoxhën e kërkojnë...

Në faqen e parë të «Këngës së madhe» ajo vuri kryeditën e shënuar, kur Enver Hoxha i dha vegjëlisë Partinë:

Kënga ime fort e thjeshtë
nis aty, ku t'i n'at vjeshtë,
u krijove e krahë more
çave retë mbi tokë arbërore...

Un' do zë këngën e madhe
lule, o shoku Enver!
atë këngë partizane,
kur gjezdisje nëpër male,
pa buk' e pa ujë fare,
bashk' me çetat partizane!

Hap pas hapi e përcolli gurra popullore Veprën e Enver Hoxhës në tallazet e revolucionit:

Kush lufton në çdo anë?
Enveri me partizanë!
Kush lufton në mal me lisa?
Enveri me komunista!

Si një sizmograf fort i ndjeshëm gurra popullore regjistroi gjithë ngjarjet sado pak të rëndësishme të përmbysjes që solli revolucioni popullor dhe të ndërtimit të jetës së re. Dhe në çdo rast populli me intuitën e tij të pagabuar e me vetëdijen e re revolucionare e lidhi çdo fitore me emrin e Enver Hoxhës. Si një det pa anë janë figurat sa të bukura e aq të thjeshta, të sinqerta, të ngjizura me afshin e zemrës, që mbushin vargjet popullore kushtuar Enver Hoxhës, në të cilat spikat mirënjohja, dashuria, besimi, respekti, nderimi i tij pa kufi. Por epiteti që parapëlqente populli ishte fjala «bir» dhe në të ai futi një kuptim të madh, shprehu identitetin e Udhëheqësit me popullin e vet. Populli ndjente se ish i tëri, i vërtetë, autentik, në fjalën e Enverit:

Fol, Enver, të lumtë goja
fol e mbro të drejtat tona
se dhe un' ashtu të doja...

Në këngën e tij populli ynë s'rreshti asnjëherë së shprehuri mirënjohjen e tij më të thellë për atë, që e udhëhoqi në rrugën e jetës së re. Dhe kënga e tij gjëmoi jo vetëm në trojet shqiptare, por edhe në të katër anët e botës, gjëmoi si këngë kushtrimi revolucionar:

Enver Hoxha tungjatjeta
sa kto male, sa kto shkrepa
zanin shqipes nalt ia ngrite,
gjith këtë popull n'drit e qite.

Gurra popullore këndoi për të në çdo skaj të Atdheut, se kudo ishte i pranishëm mendimi e veprimi i tij revolucionar. Prandaj mallin që kishin anetë gjirokastrite për birin e tyre, e kishte gjithë Shqipëria, që desh në çdo çast ta kish pranë si nëna evlanë:

Eja, eja Enver djali
Se për ty na mori malli...

Dhe ja tani gjëma mbarëpopullore:

Ç'ke moj Gjirokastra mëmë
Që nuk mbahesh dot më këmbë?
Jam përkulur këtë radhë
Të puth Enverin në ballë.
Më përkuli peshë e zisë
Si flamur në gjysmë shtizë.
Në porta dalin anetë:
Jo, mor jo, s'është e vërtetë,
Se e kishim jetëgjatë,
Ashtu si malet e lartë,
Edhe gjithë lotët e syrit
Si ruazat e floririt
Ia derdh mbi ballë birit,
Enver Hoxhë xhevahirit.
Enver, merak mos të mbetet
S'i harrojmë amanetet,
Emri Yt i gjallë do mbetet
Se të ka Ty çdo shqiptar
M'u në zemër lapidar.

Atë që ishte «zemër për çdo zemër», «ndërgjegja jonë», «qenia jonë», për të cilin «qajnë gurët, qajnë sokaqet» populli e vendos të pavdekshëm në kujtesën e tij:

Jo, s'ke vdekur, je i gjallë,
je në krye, je në ballë,
je në Shqipërinë e bardhë.

Vaji popullor sjell me vete forcën e ideve dhe të mësimeve të Enver Hoxhës, kushtrimin për të ecur përpara në rrugën e tij:

O popull, ngrehu në këmbë
Ktheje forcë këtë gjëmë!

Prof. ALFRED UÇI

NE ZEMREN E POPULLIT

- Enveri vetëm një fjalë nuk i mbajti popullit, atë që nuk rrojti sa deshi populli.

- Enveri do të na falte që një herë nuk i mbajtëm fjalën - nuk i mbajtëm dot lotët.

- Humbja e shokut Enver është një mungesë me të cilën vetë jeta nuk mësohet dot, jo njeriu.

- Shoku Enver bëri betimin «do të vdesim komunistë» dhe e mbajti.

- Vdekja nuk na mund dot, se nuk na mund dot harresa.

- Enver Hoxha gëzimin më të madh e kish kur bëheshin dasma, kur këndohej, kur lindnin fëmijë.

(Mbledhur në shtëpitë gjirokastrite të hënën, më 15 prill - nga Thanas Dino)

SKICA

Poezia e Mimozës, që u bë nënë

Shumë lotë mënjanë kam lënë
Do t'i derdh, kur të bëhem nënë,
Foshnje e vogël s'ka për të parë
Yllin e bukur, trimin e gjallë

Fotografinë, o prijës i rrallë
Do ja lë foshnjës ta ketë përballë,
Që me ty në sy të rritet
Të edukohet e të kalitet...

Të kujt janë këto vargje? - do të pyesni ju. Këto vargje janë të Mimoza Kolekës. Mimoza është vajza e Nasho dhe Aleksandra Zerecit, të dy komunistë. Brenda një dite, 6 veta: nëna, babai, dy vëllezër dhe dy motra i janë vrarë Aleksandrës, në masakrat e Borovës. Por Mimoza u rrit e gëzuar, e lumtur në vitet e ndritura të Partisë, në epokën e Enverit. Ajo mbaroi Universitetin, u martua me Sokolin. Ajo këto ditë dhimbjeje priste të bëhej nënë.

Poezia e saj, gati poemë, ka mbi 100 vargje. Nga këto shkëputëm dy strofa. Dhe ja, më 15 prill në mbrëmje ajo e mbaroi vajin e saj për humbjen e madhe. Më 16 në mëngjes Mimoza u bë nënë. Ajo lindi djalë. I vjehrri i Mozës i thotë: «Kemi dëshirën dhe mendimin, të dy familjet, moj bijë e dashur që djalit t'i vemë emrin: Shpati». «Jam shumë dakord me ju, baba. Kjo është edhe dëshira ime» përgjigjet Moza, që sapo u bë nënë.

Në jetë të jetëve, brez pas brezi jeton Enveri ynë.

Por një nga arsyet kryesore, veç të tjerave, pse i shkruajtëm këto radhë është edhe ajo që na thotë babai i Mozës, Nashua dhe bashkëshorti, Sokoli. Ata thonë se «nuk e dimë që Moza shkruan poezi».

Dhe ndërsa ata thonë një të vërtetë të tillë, na kujtohen ato dhjetra e qindra vjersha - nga populli i tërë poet - nga pionierë, nga veteranë, nga nxënës, studentë, nga i gjithë populli i Tiranës. Më vjen ndërmend një vjershë e ndjerë e pedagogut të inxhinierisë, Jani Guxos, djalë nga minoriteti, e studentit të agronomisë Luan Ahmeti, apo studentes Keti Mullaj, e... Sa shumë! Sa të mrekullueshme! Dhe përballë këtij deti këngësh, këtij lumi njerëzish, lind pyetja: «A kanë shkruar ndonjëherë këta poezi?» Jo. Është dhimbja dhe pikëllimi i madh që i bëri poetë. Në të vërtetë, ky është populli poet. Në këtë det vargjesh e në këtë lumë njerëzish bën pjesë edhe Moza, që ne i lamë një vend më të veçantë për vet ngjarjen e saj.

ASTRIT NURI

PERHERE I GJALLE

Është e shtata ditë e dhimbjes së thellë. Pranë bustit të shokut Enver Hoxha para Komitetit të Partisë së Rrethit, qëndrojnë roje nderi ushtarakë e pionierë. Njerëzit ecin të heshtur, me vështrim të pikëlluar nga busti. Sa shumë e vlerësonte udhëheqësi ynë i paharruar Fierin e njerëzit e tij.... «Fieri do të bëhet përherë e më i bukur, thoshte ai, se është një rreth me perspektivë të madhe, me pasuri të shumta, me organizatë Partie të fortë dhe me një popull punëtor».

- Ngjan si me plagën e plumbit. Kur ftohet plaga, të ther më shumë dhimbja, thotë komunisti Petro Lule, në Topojë. - Po i miri s'vdes kurrë. Për herë të parë u takova më 1958, pastaj më 1962, kur ishte i deleguar në konferencën e Partisë të rrethit. Isha kryetar kooperative në atë kohë. Ia shpreha dëshirën të na vinte në Topojë. Na dha fjalën dhe pas një viti erdhi. Në maj të vitit 1963. Pyeste për njerëzit dhe dëgjonte me vëmendje bisedat tona. Na foli për të ardhmen e Myzeqesë. Të vazhdojnë teknikumin bujqësor, sa më shumë djem e vajza.

- Si ta kapërcejmë këtë dhimbje? Ç'të kujtoj më parë nga fjalët e shokut Enver në takimin që patëm me të në nëntor të vitit 1966,- thotë punonjësja Liri Miranda, në uzinën «Gogo Nushi». Me vete mban një fotografi ku ka dalë me shokun Enver.

Kur mori vesh se isha sekretare e rinisë në këtë vepër, foli tërë gëzim: ja ç'bën Partia. Vajzat e gratë drejtojnë njëlloj si burrat. Ndërsa përpara ishte ndryshe: kur lindte vajzë qanin dhe trarët e shtëpisë e gurët e sokakut.

Në Mbrostar të Grecallisë, sekretarja e organizatës bazë të Partisë Liri Çuko, me buzët që i dridheshin nga dhimbja e pikëllimi, kujton fjalët e shokut Enver, kur erdhi këtu para 17 vjetësh, dhe bisedoi me njerëzit, aty në mes të arës, dha porosi që të mësojnë mirë agroteknikën, për t'i rritur rendimentet, se toka është e mirë sa më s'bëhet. Pastaj tha: ta mbajmë Partinë gjithnjë të re, të gjallë, të freskët. Ja, këtu midis jush ka djem e vajza të mrekullueshme, që i duhen Partisë.

VANGJEL STEFA

Fotografia

Pas lajmit të hidhur për vdekjen e njeriut më të shtrenjtë të zemrave tona, Udhëheqësit më të dashur të Partisë e të popullit shokut Enver Hoxha, nëna, duke u kujtuar për diçka me lot në sy më tha:

- Shko bir tek mësuesja jote e kopshtit, tek Naxhija, ajo më duket se ka një fotografi ku ke dalë edhe ti tok me shokët duke i dhënë lule shokut Enver. Dhe unë mora rrugën tek mësuesja ime. Sa trokita në portë, mësuese Naxhija (Mërzira) sikur e parandjeu:

- Eja djalë, eja, ke ardhur të marrësh fotografinë? T'a jap unë... dhe vu lotët.

- Unë nuk e dij, i thashë, se kam dalë në fotografi me shokun Enver. Di që shoku Enver më ka përkëdhelur në faqe kur...

- Ja, je këtu, vetëm koka të duket, e sheh. Përpara teje është Vjollca, Arjana, të kujtohen... Ne të tre mbanim lule në duar, ashtu siç ishte fiksuar në atë fotografi këtu e 25 vjet më parë, kur Udhëheqësi ynë i dashur vizitoi kopështin e fëmijëve në Burrel.

- Merre djalë, t'a jep mësuesja fotografinë, e t'a kesh si gjënë më të shtrenjtë, si porositë e tij.

- «Ja, këtu kam dalë në fotografi me shokun Enver...». Sa e sa njerëz thonë kështu sot, sa e sa fotografi të tilla ka në vatrat shqiptare anë e mbanë Atdheut. I tillë ishte ai, kurdoherë në mes të popullit, të fëmijëve, të të rinjve, të punëtorëve e të kooperativistëve, e kështu duke i pasur në shtëpitë tona këto fotografi të bukura e kemi ndjerë dhe e ndjejmë çdo ditë zërin e Udhëheqësit, porositë e tij të çmueshme dhe çdo mbrëmje i kemi thënë e do t'i themi: «Ushtarë besnikë të Partisë do të jemi në jetë të jetëve, i dashur shoku Enver».

SAMI MILLOSHI

http://www.enverhoxha.ru

IDETE E SHOKUT ENVER HOXHA, VEPRA DHE SHEMBULLI I TIJ I SHQUAR DO TE VAZHDOJNE TE RROJNE THELLE NE ZEMRAT E POPUJVE PERPARIMTARE TE BOTES

PARTI DHE PERSONALITETE SHTETERORE DHE POLITIKE TE BOTES VAZHDOJNE TE DERGOJNE NGUSHELLIME ME RASTIN E VDEKJES SE SHOKUT ENVER HOXHA

Komitetit Qendror të Partisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor, Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shokut Ramiz Alia, Sekretar i Parë i KQ të PPSH-së e Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe shokut Adil Çarçani, Kryetar i Këshillit të Ministrave, vazhdojnë t'u vijnë telegrame nga parti, kryetarë shtetesh, kryeministra, organizata dhe personalitete të ndryshme politike e shoqërore, në të cilat shprehen ngushëllimet e sinqerta dhe ndjenjat e simpatisë me rastin e vdekjes së udhëheqësit të Partisë e të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha.

Mbrojtës i shkëlqyer i interesave të masave punonjëse dhe të popujve

Në telegramin dërguar **Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë** nga **sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë Popullore Revolucionare të Kamboxhias dhe kryetar i Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kamboxhias, Heng Samrin; kryetari i Asamblesë Kombëtare dhe kryetar i Këshillit Kombëtar të Frontit të Bashkuar për Ndërtimin dhe Mbrojtjen e Atdheut Kamboxhian, Shea Sim** dhe **kryetari i Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Kamboxhias, Hun Sen,** shkruhet:

Komiteti Qendror i Partisë Punëtore Revolucionare të Kamboxhias, Këshilli i Shtetit, Asamblea Kombëtare, Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Frontit të Bashkuar për Ndërtimin dhe Mbrojtjen e Atdheut dhe populli i Republikës Popullore të Kamboxhias mësuan me hidhërim të thellë lajmin për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Shoku Enver Hoxha, udhëheqës i shquar i popullit shqiptar, mik i dashur i popullit kamboxhian, ka punuar gjithë jetën e tij për ndërtimin e vendit dhe mirëqënien e popullit shqiptar.

Në këto çaste të trishtuara ne ndajmë hidhërimin me Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, me Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, me Qeverinë, Këshillin e Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, me të gjithë popullin shqiptar dhe familjen e tij.

Në telegramin dërguar **shokut Ramiz Alia** nga **Presidenti i Kolumbisë, Belisario Betankur,** shkruhet:

Mbetem thellësisht i prekur nga lajmi i vdekjes së Shkëlqesisë së tij, Zotit Enver Hoxha, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, udhëheqësit që me orientimet e tij konsolidoi kombin, ruajti pavarësinë dhe drejtoi me vendosmëri popullin shqiptar. Dëshiroj t'ju shpreh në emrin tim personal dhe si përfaqësues i popullit dhe i qeverisë së Kolumbisë ngushëllimet më të sinqerta.

Në telegramin dërguar **shokut Ramiz Alia** nga **Emiri i Kuvajtit, Xhaber Al Ahmed Al Sabah,** shkruhet:

Me keqardhje të thellë mësuam për vdekjen e Shkëlqesisë së tij, Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Në emër të popullit të Kuvajtit e në emrin tim dëshiroj që t'i shpreh Shkëlqesisë suaj si dhe popullit mik të Shqipërisë ngushëllimet dhe simpatinë time të sinqertë me rastin e kësaj humbje të madhe.

Në telegramin dërguar **Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë** nga **Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Afrikane për Pavarësinë e Kepit të Gjelbër, president i Republikës së Kepit të Gjelbër, Aristides Pereira,** shkruhet:

Me keqardhje mësova vdekjen e Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Në këto çaste hidhërimi për popullin shqiptar, në emër të popullit të Kepit të Gjelbër, të Partisë, të Qeverisë dhe në emrin tim personal, ju dërgoj ngushëllimet tona të dhimbshme për popullin, Partinë dhe Qeverinë shqiptare, si dhe për familjen e Udhëheqësit të shquar.

Në telegramin dërguar **shokut Ramiz Alia** nga **Presidenti i Republikës Popullore të Bangladeshit, Hussain Muhamad Ershad,** shkruhet:

U preka shumë kur mësova për humbjen e Shkëlqesisë së tij, Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Me këtë rast të hidhur, në emër të Qeverisë dhe të popullit të Bangladeshit dhe në emrin tim, u shpreh ngushëllimet tona të thella Qeverisë dhe popullit të Shqipërisë dhe i lutem Shkëlqesisë tuaj t'i transmetoni simpatitë tona të sinqerta familjes së Udhëheqësit.

Në telegramin dërguar **shokut Ramiz Alia** nga **Presidenti i Republikës së Perusë, Fernando Belaunde Terri,** shkruhet:

Në emër të popullit dhe të Qeverisë Peruane dhe në emrin tim personal pranoni, Shkëlqesi, shprehjet tona më të dhimbshme, për vdekjen e udhëheqësit të popullit shqiptar, Zotit Enver Hoxha.

Përfitoj nga rasti për t'i shprehur Shkëlqesisë tuaj, ndjenjat e konsideratës time më të lartë dhe më të shquar.

bashkatdhetarë me banim të përhershëm në Bullgari.

Për të shprehur ngushëllimet, në ambasadën tonë në **Pekin** shkuan zëvendëskryetari i Këshillit të Shtetit të RP të Kinës, Li Pen; zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Xhou Nan; zëvendësministri i Tregtisë së Jashtme, Li Ke, dhe personalitete të tjera. Në emër të presidentit të RP të Kinës, Li Hsien Nien, u vendos një kurorë me lule.

Në ambasadën tonë në **Berlin,** në emër të Kryetarit të Këshillit të Shtetit të Republikës Demokratike Gjermane, Enrih Honeker, bëri homazhe Sekretari i KQ të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, deputeti Verner Jarovinski. Gjithashtu bënë homazhe zëvendëskryetari i parë i Këshillit të Ministrave, Verner Krolikovski, dhe sekretari i shtetit dhe zëvendësi i parë i ministrit të Punëve të Jashtme, dr. Herbert Krolikovski, zëvendësministri i Tregtisë së Jashtme, Vilhelm Bostram, etj.

Në ambasadën tonë në **Budapest** ishin për të paraqitur ngushëllimet për vdekjen e shokut Enver Hoxha, anëtari i Këshillit të Presidencës së Republikës Popullore të Hungarisë, Sandor Nagi, zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Hungarisë, Istvan Roska dhe personalitete të tjera.

Në Misionin e RPS të Shqipërisë pranë OKB-së, në **Nju-Jork** për të nderuar kujtimin e shokut Enver Hoxha shkuan një numër i madh përfaqësuesish të përhershëm të shteteve të ndryshme anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara si edhe funksionarë të lartë të kësaj organizate.

Gjithashtu, edhe në përfaqësitë diplomatike të RPS të Shqipërisë në **Greqi, Francë, Çekosllovaki, Egjipt, Kubë, Poloni** dhe **Meksikë,** këto ditë kanë shkuar për të shprehur ngushëllimet personalitete të institucioneve të ndryshme shtetërore, shoqërore, të shkencës e kulturës, nga rrethet publicistike e tregtare, si dhe nga shumë miq e dashamirës të vendit tonë.

* * *

Edhe ditën e dytë të hapjes së librit të ngushëllimeve për vdekjen e shokut Enver Hoxha, në ambasadat tona në **Hanoi, Ankara, Vjenë, Romë,** etj., kanë shkuar për të bërë homazhe edhe personalitete të tjera të larta politiko-shoqërore të këtyre vendeve.

Në ambasadën e RPS të Shqipërisë në **Ankara** vazhduan të bëjnë homazhe ministri i Shtetit për tregtinë, Mustafa Tinaz Titiz, zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Turqisë, Metin Karaca. Ishin gjithashtu, ish-kryeministri i Turqisë, Sulejman Demirel, ish-kryetari i Senatit të Turqisë, gjeneralarmate në pension Tekin Aribarun dhe personalitete të tjera të vendit. Në shënimin e lënë në librin e ngushëllimeve, Mustafa Tinaz Titiz, ndër të tjera shkruan: «..Dëshiroj të shpreh ngushëllimet tona për humbjen e udhëheqësit të madh të kombit tuaj, Enver Hoxha. Ai do të kujtohet nga kombi turk jo vetëm për madhështinë e tij si një nga udhëheqësit më të respektuar të botës, por edhe si një mik i ngushtë i Turqisë...», ndërsa ish-kryetari i Senatit turk, Tekin Aribarun, shkruan: «Me rastin e humbjes së Enver Hoxhës, udhëheqës shumë i nderuar i Shqipërisë heroike, ndajmë me ju dhimbjen. Paraqesim ngushëllimet tona duke shprehur për Enver Hoxhën po atë vlerësim, dashuri dhe nderim që ruajnë të gjithë turqit për Ataturkun tonë të madh».

Në ambasadën tonë në **Hanoi** shkuan për të bërë homazhe dhe për të nënshkruar librin e ngushëllimeve ministri i Tregtisë së Brendshme, Le Suk Thanj, ministri i Arsimit të Lartë, Ngujen Ding Tu, dhe personalitete të tjera.

(ATSH)

Nderim për atë që e bëri Shqipërinë shembull përpara botës

– Homazhe për vdekjen e shokut Enver Hoxha në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit –

Në përfaqësitë tona diplomatike jashtë shtetit vazhdojnë të shkojnë për të bërë homazhe për vdekjen e udhëheqësit të dashur të Partisë dhe të popullit tonë, shokut Enver Hoxha, personalitete të shumta politiko-shoqërore të vendeve të ndryshme, përfaqësues të institucioneve qëndrore shtetërore, të organizatave të masave, etj.

Në ambasadën tonë në **Phenian,** në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Koresë, shkuan për të bërë homazhe anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe zëvendëspresidenti i Republikës Demokratike Popullore të Koresë, Pak Sen Çer, anëtari i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetari i Këshillit Administrativ, Kim Huan, zëvendësdrejtori i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë, Kil Xhe Liang, dhe shokë të tjerë. Ishin gjithashtu për të bërë homazhe zëvendësministri i Punëve të Jashtme Kim Xhe Suk, zëvendësministri i Mbrojtjes Popullore, gjeneralarmate Kim Puan Xhin.

Për të nderuar kujtimin e udhëheqësit të Partisë e të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha, në emër të Qeverisë së Argjentinës shkoi në ambasadën e RPS të Shqipërisë në **Buenos-Aires,** ministri i Energjetikës Bruno Ferrari Bono, i cili la këtë shënim në librin e ngushëllimeve: «Nderim atij që duke u shërbyer idealeve të vendit, diti të ringjallë ndjenjat e të parëve dhe ta kthejë Shqipërinë në shembull përpara botës».

Në ambasadën tonë në **Beograd** bënë homazhe Radovan Vllajkoviç, nënkryetar i Presidencës së RSF të Jugosllavisë; Dr. Milorad Stanojeviç, anëtar i Këshillit Federativ të Kuvendit të RSF të Jugosllavisë; Budimir Lonçar, zëvendëssekretar Federativ për Punët e Jashtme; Andrej Grahor, zëvendëskryetar i Komitetit Federativ për Komunikacionin e Ndërlidhjen dhe funksionarë të tjerë të Sekretariatit Federativ për Punët e Jashtme, të Sekretariatit Federativ për Tregtinë e Jashtme, etj.

Në ambasadën tonë në **Vjenë** paraqitën ngushëllimet dhe firmosën në libër shumë personalitete të jetës politike, shoqërore dhe ekonomike të Republikës Austriake. Ndër personalitetet politike të vendit, në emër të Qeverisë së Republikës së Austrisë bëri homazhe ministri i Punëve të Jashtme, Leopold Grac, i shoqëruar nga shefi i Kabinetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ambasadori Ditrih Buovski dhe shefi i Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ambasadori Kristof Kornaro, etj. Shkuan gjithashtu për homazhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare me qendër në Vjenë si drejtori i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Energjinë Atomike (INATOM), Hans Bliks, etj. Po kështu bënë homazhe kryetari i Partisë Komuniste Gjermane, Horst Ditrih Koh, dhe të tjerë.

Në ambasadën tonë në **Stokholm** shkuan për të bërë homazhe dhe për të paraqitur ngushëllimet zëvendëskryetarja e Parlamentit suedez, Ingegerd Troedson, sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme Pjer Shori, personaliteti i njohur, ambasadori Gunar Jaring, përfaqësues të artit, kulturës, shkencës, etj. Librin e ngushëllimeve e nënshkroi gjithashtu edhe sekretari i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (marksiste - leniniste) të Danimarkës, Jorgen Petersen.

Në ambasadën tonë në **Sofje** shkuan për të shprehur ngushëllimet për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Penço Rubadinski, Kryetar i Frontit Patriotik të RP të Bullgarisë; Mitko Grigorov, zëvendëskryetar i Këshillit të Shtetit dhe zëvendëskryetar i Kuvendit Popullor, Ivan Ganev, zëvendësministër i Punëve të Jashtme; Marin Marinov, zëvendësministër i Tregtisë së Jashtme e të tjerë.

Bënë homazhe, gjithashtu, edhe

PATRIOTI ME I MADH I KOMBIT SHQIPTAR

– Telegrame ngushëllimi nga shoqëritë patriotike dhe nga shqiptarë e bashkatdhetarë me banim jashtë atdheut –

Komitetit për Marrëdhënie Kulturore dhe Miqësore me Botën e Jashtme i kanë ardhur këto ditë shumë telegrame nga shoqëritë patriotike dhe nga **shqiptarë e bashkatdhetarë me banim jashtë Atdheut,** në të cilat shprehet dhimbja e tyre e thellë për vdekjen e Udhëheqësit të Partisë e të popullit tonë, shokut Enver Hoxha.

Në telegramin e **Organizatës Patriotike «Shqipëria e Lirë»** dhe të **organit të saj «Liria»** me qendër në **Boston të SHBA-së,** shkruhet:

«Me hidhërim të thellë mësuam vdekjen e udhëheqësit dhe patriotit të kombit dhe të popullit shqiptar, Zotit Enver Hoxha, çlirimtari i Shqipërisë nga pushtuesit e huaj, arkitekti i Shqipërisë së re dhe mbrojtësi i kombit dhe i popullit shqiptar për 45 vjet me radhë. Lutemi me këtë rast t'i transmetoni tërë popullit shqiptar, familjes shumë të pikëlluar, autoriteteve kompetente të Qeverisë dhe të Partisë së Punës, Komitetit për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme ngushëllimet tona më të sinqerta për këtë humbje të madhe. Kujtimi i tij qoftë i përjetshëm!».

Në telegramin e **kryetarit të degës «Naim Frashëri» të Organizatës Patriotike «Shqipëria e Lirë» në SHBA, Hulusi Kavo,** shkruhet:

«Shpreh ngushëllimet më të thella për humbjen e udhëheqësit të dashur e të madh të Partisë së Punës të Shqipërisë, të popullit dhe të shqiptarëve patriotë kudo në botë, shokut e mikut tonë Enver Hoxha. Lutemi vendosni një kurorë me lule në emër të degës «Naim Frashëri».

Në telegramin e **një grupi shqiptarësh me banim në Rumani** shkruhet:

«Lajmi i hidhur i vdekjes së shokut Enver Hoxha ra si një rrufe edhe në zemrat tona. Lajm plot dhimbje, që na tronditi dhe na mbushi sytë me lot.

Njeriu më i vyer dhe udhëheqës i ndritur i Partisë dhe i popullit shqiptar iu nënshtrua vetëm ligjeve të natyrës, duke lënë prapa veprën e madhe historike të punës së tij dhe kujtimin e një jete revolucionare, heroike, të mençur dhe me aftësi të pakrahasueshme që do të mbetet shembull në historinë botërore.

Si themelues i Partisë, Udhëheqës i Luftës Nacionalçlirimtare, Kryetar i Frontit Demokratik, Komandant i Forcave të Armatosura dhe arkitekt i ndërtimit të shoqërisë së re socialiste, në krye të kësaj pune gjigande me përgjegjësi prej më shumë se 44 vjet, i dha fund dhe njërës prej plagëve të së kaluarës të popullit-mërgimit, duke u krijuar njerëzve mundësinë e punës.

Mësimet e tij, do të frymëzojnë gjithmonë popullin shqiptar në vazhdimin e ndërtimit të socializmit dhe në mbrojtjen e Atdheut. Si një grusht tërë shqiptarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë, do t'i ruajnë dhe do t'i vënë ato në jetë. Qoftë i paharruar brez pas brezi vepra dhe emri i tij».

(ATSH)

BURRE SHTETI I JASHTEZAKONSHEM QE LUAJTI NJE ROL AKTIV NE POLITIKEN BOTERORE

– TELEGRAME NGUSHELLIMI DERGUAR KOMITETIT QENDROR TE PPSH-së, SHOKUT RAMIZ ALIA DHE KOMITETIT PER MARREDHENIE KULTURORE DHE MIQESORE ME BOTEN E JASHTME –

Në telegramin e **kryetarit të Shoqatës së Miqësisë Suedi-Shqipëri,** shkruhet:

«Në emër të Këshillit Drejtues dhe të gjithë anëtarëve të Shoqatës Suedi-Shqipëri, dëshiroj të shpreh simpatinë më të thellë dhe ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e shokut Enver Hoxha, udhëheqës shumë i dashur i popullit shqiptar.

Shoku Enver ishte personaliteti më i shquar dhe burrë shteti i jashtëzakonshëm, që luajti një rol aktiv në politikën botërore për afro një gjysmë shekulli. Duke qenë një patriot i madh gjatë gjithë jetës së tij, ai mbajti një qëndrim aktiv që në rini në luftën për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë së tij të dashur. Ai mishëron në fakt karakterin e vërtetë të shqiptarit, trimërinë, dashurinë për lirinë, këmbënguljen në mbrojtjen e parimeve. Këto cilësi ai i ka treguar gjithmonë gjatë shumë betejave që zhvilloi për të çliruar, për të mbrojtur dhe për ta shndërruar Shqipërinë në një vend të lumtur e të lulëzuar.

Gjatë epokës së udhëheqjes së tij, Shqipëria u transformua nga një vend i prapambetur i Evropës në një shtet të pavarur me një industri e bujqësi të zhvilluar, me një mirëqënie për të gjithë popullin, në një shtet që mbështetet në përpjekjet e popullit të vet. Në sajë të veprës së tij, Shqipëria sot ka fituar një respekt të madh dhe shumë miq në të gjitha anët e botës. Zëri i Shqipërisë dhe qëndrimet e saj kurajoze kundër shtypjes e luftërave të padrejta kanë frymëzuar të gjithë popujt e vegjël që të mos dorëzohen ndaj kërcënimeve të fuqive të mëdha. Kjo humbje është shumë e madhe për shqiptarët, por vepra e shokut Enver Hoxha mbetet bazë e qëndrueshme me të cilën populli shqiptar do të marshojë përpara drejt fitoreve të reja të lavdishme. Vepra e shokut Enver Hoxha me siguri do të kujtohet përgjithmonë, idetë e tij, shembulli i tij i shquar do të vazhdojë të rrojë thellë në zemrat e popujve përparimtarë të botës. Lavdi kujtimit të shokut Enver Hoxha!».

Në telegramin e tij **Këshilli Kombëtar i Shoqatës së Miqësisë Danimarkë-Shqipëri,** midis të tjerash, shkruan:

«Ju shprehim juve dhe nëpërmjet jush gjithë popullit shqiptar ngushëllimet tona të sinqerta me rastin e vdekjes së shokut Enver Hoxha. Shprehim hidhërimin tonë të thellë dhe solidaritetin me popullin shqiptar, i cili humbi birin e tij më të madh dhe udhëheqësin e dashur.

Me vdekjen e shokut Enver Hoxha klasa punëtore, populli dhe lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare kanë humbur një nga udhëheqësit e tyre më të shtrenjtë. Emri dhe vepra e Enver Hoxhës do të rrojë përjetë».

(ATSH)

KOLEGJIUMI I REDAKSISE

ADRESA E REDAKSISË, «ZËRI I POPULLIT», BULEVARDI «STALIN», Tiranë. TELEFONAT: Zëvendëskryeredaktori 78-13, sekretari i kolegjiumit 75-58, përgjegjësi i sektorit ideologjik 78-11, sektori ideologjik 78-14 dhe 78-07, përgjegjësi i sektorit ekonomik 78-10, sektori i ekonomisë 64-75, përgjegjësi i sektorit të jashtëm 78-08, sektori i jashtëm 21-92, përgjegjësi i sektorit të brendshëm dhe i letrave 78-09, sektori i brendshëm dhe i letrave 33-87, sekretariati dhe shërbimi i natës 78-07, administrata dhe kartoteka 78-12, nëpunësi i rojës 30-84. PAJTIMET: për një vit 94,80 lekë, për 6 muaj 47,40 lekë. Për jashtë shtetit: 130 lekë për një vit, 70 lekë për 6 muaj

http://www.enverhoxha.ru